

**Akt Themelimi i Shoqërisë
me Përgjegjësi të Kufizuar të
“Grape & Wine Albania” Sh.p.k.**

Neni 1

Themelimi

1. Emri i shoqërisë është **“Grape & Wine Albania” Sh.p.k.**, (këtu e më poshtë **“Shoqëria”**). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
2. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e më poshtë quajtur **“QKB”**).
3. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statusin e saj.
4. Shoqëria themeleohet sot, më ditë e diel, **16 Shkurt 2025**.

Neni 2

Selia

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Bardhok Biba”, Zona Kadastrale 8360, Volumi, 22, Faqe 117, me numër pasurie 6/150-N45, ish-kinema “17 Nëntori”, Tiranë, Shqipëri.
2. Shoqëria mund të themelojë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshëm dhe Statutin.

Neni 3

Objekti

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të përfshijë fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve profesionale, duke u fokusuar në një gamë të gjerë veprimtarish që kontribuojnë në zhvillimin dhe rritjen e efikasitetit të klientëve të saj, si vijon:

1. Ofrimi i shërbimeve profesionale


1.1 Kultivimi dhe përpunimi i rrushit

Shoqëria do të merret me mbjelljen, kultivimin dhe mirëmbajtjen e vreshtave, duke aplikuar teknika bashkëkohore për rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së prodhimit.

1.2 Prodhimi dhe tregtimi i verës dhe nënprodukteve të rrushit

Shoqëria do të angazhohet në procesin e fermentimit, përpunimit dhe ambalazhimit të verës, si dhe në prodhimin dhe tregtimin e nënprodukteve të rrushit, si lëngje, uthull, distillate dhe produkte të tjera të ngjashme.

1.3 Importi dhe eksporti i produkteve të vreshtarisë



Shoqëria do të importojë dhe/ose eksportojë lloje rrushi dhe të vreshtarisë, duke përfshirë fidanë, plehra kimikë, ushqyes dhe produkte të tjera të lidhura me vreshtarinë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.4 Zhvillimi i strategjive dhe konsulencë në vreshtari dhe verëtari

Shoqëria do të ofrojë shërbime konsulence dhe mbështetje për kultivues dhe prodhues të verës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- 1.4.1 Hartimin dhe zbatimin e strategjive të menaxhimit të vreshtave dhe verëtarisë dhe proceseve të kultivimit dhe prodhimit;
- 1.4.2 Optimizimin e metodave të vreshtarisë dhe verëtarisë;
- 1.4.3 Zhvillimin e strategjive të marketingut dhe tregtimit për përmirësimin e pozicionit në treg.

1.5 Bashkëpunime dhe zhvillim projektesh në fushën e vreshtarisë

Shoqëria do të zhvillojë dhe zbatojë projekte të ndryshme në këtë fushë, nga faza e ideimit dhe planifikimit deri në zbatimin praktik, duke përfshirë partneritete me subjekte vendase dhe ndërkombëtare për modernizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve.

1.6 Nënkontraktimi i shërbimeve të specializuara

Shoqëria mund të nënkontrakttojë shërbime të ndryshme për të siguruar efikasitet dhe cilësi të lartë në të gjitha proceset e saj.

1.7 Aktivitete mbështetëse dhe të lidhura

Shoqëria do të kryejë konsultimin e palëve të treta, duke përfshirë por pa u kufizuar në organet e pushtetit qendror dhe lokal.

Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari të ligjshme që lidhet drejtpërdrejt ose indirekt me objektin e saj kryesor të veprimtarisë, përfshirë trajnimin e stafit, pjesëmarrjen në panaire dhe promovimin e produkteve të saj.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100.00** lekë (**njëqind lekë**), e përbërë nga **4 (katër)** kuota, me vlerë totale **100.00** lekë (**një qind lekë**), ndarë si më poshtë vijon.

Ortakët e Shoqërisë janë:



- **Z. Florian Tafili**, lindur më **15 Shkurt 1988**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Rruga "Aleks Buda", Palli "Jon 2002", Shkalla 2, Apartamenti 2, 1022, Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **I80215067L**, i cili zotëron **1 (një)** kuotë, duke investuar në **26.5 % (njëzet e gjashtë pikë pesë përqind)** të Shoqërisë, ose **26.5 lekë (njëzet e gjashtë pikë pesë lekë)**; me zotësi të plotë juridike për të vepruar; dhe

- **Z. Leonard Maçi**, lindur më **13 Prill 1971**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Bulevardi "Petro Nini Luarasi", Nd. 38, H. 2, Ap. 8, Njësia Bashkiake Nr. 2, 1001, , Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **H10413057P**, i cili zotëron **1 (një)** kuotë, duke investuar në **24.5 % (njëzet e katër pikë pesë përqind)** të Shoqërisë, ose **24.5 lekë (njëzet e katër pikë pesë lekë)**; me zotësi të plotë juridike për të vepruar; dhe

- **Z. Alban Ruli**, lindur më **12 Nëntor 1975**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Rruga "Siri Kodra", Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **H51112087F**, i cili zotëron **1 (një)** kuotë, duke investuar në **24.5 % (njëzet e katër pikë pesë përqind)** të Shoqërisë, ose **24.5 lekë (njëzet e katër pikë pesë lekë)**; me zotësi të plotë juridike për të vepruar; dhe

- **Z. Francesco Schiavone**, lindur më **09 Qershor 1985**, në Lizzano (TA), Itali, dhe banues në adresën: Rruga "Maliq Muço", Pallati 12, Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **I53609001V** (me numër të pasaportës italiane **YB8017352**), i cili zotëron **1 (një)** kuotë, duke investuar në **24.5 % (njëzet e katër pikë pesë përqind)** të Shoqërisë, ose **24.5 lekë (njëzet e katër pikë pesë lekë)**; me zotësi të plotë juridike për të vepruar; me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

2. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 6

Kuota dhe Transferimi

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Neni 7

Administratori

1. Shoqëria administrohet nga Administratori i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.



2. Administratori i parë i Shoqërisë është **Z. Florian Tafili**, lindur më **15 Shkurt 1988**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Rruga "Aleks Buda", Pallati "Jon 2002", Shkalla 2, Apartamenti 2, 1022, Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **I80215067L**; me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. Mandati i Administratori(ët) është 3 (tre) vjet, i rinovueshëm, dhe mund të zgjatet deri në vendimin pasardhës të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, që vendos për rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e Administratorit(ve) të ri(nj).
4. Mandati i Administratorit të parë të Shoqërisë, **Z. Florian Tafili**, nis sot, ditë e diel, 16 Shkurt 2025, deri më datë 15 shkurt 2028.

Neni 8

Drejtuesi teknik

1. Drejtues i parë teknik i Shoqërisë është **Z. Francesco Schiavone**, lindur më **09 Qershor 1985**, në Lizzano (TA), Itali, dhe banues në adresën: Rruga "Maliq Muço", Pallati 12, Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **I53609001V** (me numër të pasaportës italiane **YB8017352**); me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Drejtuesi teknik ka të drejtat dhe detyrimet e njohura nga legjislacioni në fuqi.
3. Mandati i Drejtuesit të parë teknik, **Z. Francesco Schiavone**, nis sot, ditë e diel 16 Shkurt 2025, deri më datë 15 shkurt 2028.

Neni 9

Viti financiar

1. Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2025.

Neni 10

Të ndryshme

Ky Akt Themelimi nënshkruhet në **5 (pesë)** kopje origjinale, në shqip.

Ortakët e Shoqërisë janë:

- **Z. Florian Tafili**, lindur më **15 Shkurt 1988**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Rruga "Aleks Buda", Pallati "Jon 2002", Shkalla 2, Apartamenti 2, 1022, Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **I80215067L**; dhe




- **Z. Leonard Maçi**, lindur më **13 Prill 1971**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Bulevardi “Petro Nini Luarasi”, Nd. 38, H. 2, Ap. 8, Njësia Bashkiake Nr. 2, 1001, , Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **H10413057P**; dhe
- **Z. Alban Ruli**, lindur më **12 Nëntor 1975**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Rruga “Siri Kodra”, Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **H51112087F**; dhe
- **Z. Francesco Schiavone**, lindur më **09 Qershor 1985**, në Lizzano (TA), Itali, dhe banues në adresën: Rruga “Maliq Muço”, Pallati 12, Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **I53609001V** (me numër të pasaportës italiane **YB8017352**), të gjithë me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe kuptuar, dhe me vullnetin e tyre të plotë, e nënshkruajnë rregullisht këtë dokument sipas ligjit, sot më ditë **e diel, 16 Shkurt 2025**.

Ortakët e “Grape & Wine Albania” Sh.p.k.


Z. Florian Tafili

FLORIAN TAFILI 

Z. Alban Ruli

Alban Ruli 

Z. Leonard Maçi

Leonard Maçi 

Z. Francesco Schiavone

Francesco Schiavone 